

RAPORT i audituesit te pavarur

*mbi auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga
Partia E TE DREJAVE TE MOHUARA E RE per fushaten zgjedhjeve lokale te
08.05.2011.*

Ekspert Kontabel i Regjistruar
Lulash PJETERNIKAJ
Rruga "Sulejman Pasha" Vila nr.88,kati i pare
Tirane.

Raport i Audituesit te pavarur
mbi auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga
Partia Te Drejtave te Mohuara e Re per fushaten zgjedhore lokale te 08.05.2011.

KOMISJONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE!

Te nderuar zoterinj

Une kam audituar pasqyrat financiare mbi fondet e perfituara dhe te shpenzuara nga Partia *Te Drejtave te Mohuara e Re per fushaten zgjedhore lokale te 08.05.2011*. sipas pasqyres bashkangjitur te ardhura dhe shpenzime per kete periudhe .

Drejtimi eshte pergjegjes per pergaditjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me ligjin nr.10019 dt.29.12.2008 .“Kodi Zgjedhor i republikes se Shqiperise“ dhe Ligjit nr.9228 dt 29.04.2004,“Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“

Pergjegjesia jone si auditues eshte qe te shprehim nje opinionon mbi kete pasqyre financiare bazuar ne auditimin tone .

Ne e kryem auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimi (standarti 800).Keto standarte kerkojne qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditimin tone per te pasur nje siguri te aresyeshme se kjo pasqyre nuk permban anomali materiale .

Auditimi perfshin shqyrtimin mbi bazen e testeve ,te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare .

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per te mare evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare .Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit duke perfshire vleresimin e rrezeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare,qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit . paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtateshme per rrethanet.

Auditimi perfshin gjithashtu vleresimin e pershtateshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe vleresimet e rendesishme e çmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe per vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyres.

Une besoj se evidencia e auditimit qe une kam mare perben nje baze te aresyeshme per te shprehur opinionin:

Per mendimin tim ,pasqyra e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore 08.05.2011 nga Partia e *Te Drejtave te Mohuara e Re* paraqitet ne menyre te sinqerte,ne te gjitha aspektet materiale.

Tirane 29.12.2011

Ekspert Kontabel i Regjistruar
Lulash PJETERNIKAJ lic.109,dt 21.12.2000.
Rruga "Sulejman Pasha" Vila Nr.88. kati I pare.

Shenime mbi Pasqyren financiare per fondet e perfituara dhe te shpenzuara nga Partia Te Drejtave te Mohuara e Re per fushaten e zgjedhjet Lokale te 08.05.2011.

Partia Te Drejtave te Mohuara e Re eshte futur ne zgjedhjet e 08.05.2011 , dhe sipas te dhenave te mara nga drejtuesit e Partise, per fushaten zgjedhore nuk ka perfituar fondet te dhena nga buxheti i shtetit .

Nga sponsorizimete e individeve persona fizik per fushaten zgjedhore 2011 jane perdorur 1.236.000 leke.

Nepermes bankes nuk ka hyre asne financim, Jane perdorur (cash ne dore) kane hyre 1.236.000 leke. Na eshte paraqitur tabela e dhurimeve te individeve te cilat jane ne vlera te vogla.Seicili individ dhurues per Partine e Te Drejtave te Mohuara e Re ka dhuruar nevlere 400 leke.

Fondi i perfituar nga individet per kete fushate ka qene ne vleren 1.236.000 leke .

Numri I llogarise se Partise Te Drejtave te Mohuara e Re eshte ne BKT 401180288.

Llogari tjeter nuk na eshte deklaruar.

Fondi i perfituar nga dhurimet eshte administruar nga drejtimi , eshte detajuar dhe perdorur sipas nevojave siç paraqitet ne tabelen bashkengjiur.

Totali i shpenzimeve faktike te perdorura perputhet me financimin e bere nga personat individ.

Shpenzimet e kryera jane bere pa fatura dhe ne pergjirhesi nuk jane mbajtur dokumenta justifikuese.

Sipas dokumentacionit te finances nuk kishte fonde te tjera te shpenzuara gjate fushates ,

Per shpenzime te tjera te kryera nga Kandidatet ne menyre te pavarur nuk kishte te dhena te tjera .

Sa me siper per menyren e pasqyrimet te dhenave per perfitimet dhe shpenzimet e fondeve te fushates theksoj se ka mangesi ne mbajtjen e dokumentacionit.

Rekomandoj qe ne te ardhmen te ndryshoje praktika sidomos ne lidhje me shpenzimet per te cilat duhet te behen me fatura te rregullta sipas Ligjeve fiskale dhe Ligjit "Per Kontabilitetin"

Pasqyra e meposhtme eshte e njejte me pasqyren qe subjekti na ke vene ne dispozicion.

Lulash PJETERNIKAJ lic.109,dt 21.12.2000.
Rruga "Sulejman Pasha" Nr.88.

PARTIA *Te Drejatve te Mohuara e Re*

Pasqyra e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per fushaten zgjedhore 2011 .

| Nr. | Emertimi i te ardhura dhe shpenzime | Arketime ne leke | Pagesa ne leke | Gjendje |
|-----|---|------------------|----------------|---------|
| 1 | Fondi i Fushates nga buxheti | 0 | | |
| 2 | Dhurime nga individe. | 1.236.000 | | |
| 3 | | | | |
| 4 | Shpenzime per postera e fletepalosje. | | 600.000 | |
| 5 | Shpenzime Telefonike (Vodafo dhe fix) | | 180.000 | |
| 6 | Shpenzime per blerje karta telefoni. | | 100.000 | |
| 7 | Shpenzime operative per qarqet | | 6.000 | |
| 8 | Shpenzime kancelarie. | | 50.000 | |
| 9 | Shenzim per e fotokpje internet | | 300.000 | |
| 10 | Shpenzim per ngjitje posterash. | | | |
| 11 | Shpenzime per blerje karburanti. | | 100.000 | |
| 12 | Shpenzime per spote televiziv.(tv | | | |
| 13 | Shpenzime per qera salla e zyra fushaten | | 0 | |
| | | | | |
| | | | | |
| | totali | 1.236.000 | 1.236.000 | 0 |

Kryetari
Fatmir Hoxha